

Emri i Lëndës : Bazat e Teorive te Perkthimit							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 306	C	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	6.00
Lektori		Agron Tufa, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Kursi i lëndës Bazat e Teorive të Përkthimit në nivelin Bachelor do të ndihmojë studentët të nxënë njohuri që janë në funksion të përcaktimit të teorive bazë të përkthimit, të llojeve të saj si dhe të disiplinave gjuhësore të përafërta dhe metodës, si bazë e zgjidhjeve të problemeve të përkthimit në praktikë, me gojë apo me shkrim, të nënlllojeve të ndryshëm të kësaj discipline shkencore, duke ardhur në ndihmë të ndërtimit dhe përcaktimit të koncepteve për strategji teorike, planifikim strategjik, për menaxhim efektiv të lëndës. Bazat e Teorive të Përkthimit ndihmojnë në përgatitjen për realizimin e një kthimi të mirë që njëherazi mund të vlejë për të rifituar besimin në dobinë dhe vlerën përparimsjellëse të përkthimit, të kuptuar jo thjesht si kthim të fjalëve nga një gjuhë në një tjetër, por si përpunim kritik i një përvoje, si fitim aftësie (të vlefshme për të ardhmen) për të zbuluar problemet, për t`i trajtuar në mënyrë metodike ato dhe për t`i parashtruar sipas disa mënyrave komunikuese të caktuara. Ky kurs ligjëratash ka për qëllim të shpjegojë se si mund të kryhet një kthim që mbështetet në bazën filozofike dhe metodën e duhur, duke dhënë kështu ndihmesë teoriko-kritike rreth dobisë së të marrit me kthime të cilat, veçmas në kushtet tona, janë ndihmesë në studime, por dhe do të udhëzojë e ndihmojë lidhur me mënyrën se si mund të punohet një punim konkret. Thënë më shkurt, programi përmban sasi të mjaftueshme të materialeve teorike, për t`i dhënë rëndësi të veçantë punës praktike, nga e cila krijohet një bazament i qëndrueshëm për të ndërtuar intelektualisht edhe këtë lloj komunikimi.					
Objektivat		1. Studenti do të krijojë bindjen se një përkthim nuk varet vetëm nga konteksti gjuhësor, por edhe nga dicka që qëndron përtej tekstit dhe që do ta quajmë informacion mbi botën ose informacion enciklopedik. Të marrë njohuri të imta mbi teoritë bazë, si dhe mbi metodat e sprovuara shkencore të përkthimit, duke iu qasur konkretisht praktikave të përkthimit. 2. Të përvetësohen konceptet operative për të nxitur përvetësimin e njohurive që kanë të bëjnë me zgjedhjen e bazës teorike të përkthimit në hartimin me shkathtësi, si një përgatitje moderne, pa të cilën është vështirë të rreshtohen studentët në rrafshin e të kuptuarit, të interpretimit, të pavarësimit si dhe të daljes nga rrethi vicioz i kohës. 3. Të arrijnë studentët që duke aplikuar instrumentët metodologjikë, të mundësojnë shqyrtimet teorike duke kaluar në veprime konkrete, në hulumtime, observime dhe përkthime të specialitetit, të terminologjisë, të krahasuar deri në interpretime konsektive apo simultane. 4. Kursi i ligjëratave bachelor mundëson veprim origjinal, të pavarur, komunikim me vlerat e shkuara, edhe në kultura të tjera, si dhe të skicimit të ideve me performancë të dobishme për zhvillimin e tërësishëm të kulturës, duke u miqësuar me bazen teorike dhe pse jo edhe praktikën e teknikën e përkthimit, si parakusht i gjithë nevojave të tjera ne komunikim, por edhe për ecurinë e punimeve shkencore-kërkimore.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje në bazat e teorive të përkthimit. Çështjet kryesore - Simbolika e përkthimit: Lavdia e papagallit; Dukuria e përkthimit; Përkthimi si dukuri e jetës shoqërore dhe kulturës njerëzore;						

2	Përvoja përkthimore dhe mitet; Babiloni - simboli i përkthimit dhe... gabimi i interpretimit; Zoti-interpretues, Hermes; Bota antike greke dhe përkthimi; Septuaginta.
3	Problemet përkthimore të Antikitetit; Përkthimi në Romën e lashtë. Teoricienwt e parw: Ciceroni dhe Horaci.
4	Përkthimi në periudhën e Mesjetës së hershme. Përkthimet e para të Biblës; Roli teorik dhe praktik i Shwn Jeronimit, pwrkthimi i Biblws (Vulgata) nw latinisht. Përkthimi i parë i plotë i Biblës (384 e.j)
5	Përkthimi në Mesjetë; Teoritw e para: Johan Witcliff; W. John Purvey; William Tyndale (1494-1536); Gjon Buzuku dhe
6	Përkthimet e para laike në Europë. Arsimiti dhe gjuha amtare; Lindis Farma (700 p.K.); Mbreti Alfred dhe "Cura pastoralis" (vitet 871-899); funksionalizimi i tekstit të përkthyer në shoqëri; Roger Bacon (1214-1292); Dante Alighieri (1265-1321); Geoffrey Chaucer. Punimet e para mbi teoritë e përkthimit: Etienne Dolet (1503-1546): "Si të përkthesh mirë nga njëra gjuhë në tjetrën". George Chapman-it (1559-1634); Idetë përkthimore në epokën e Rilindjes; Edmond Cary; Fenimore Holand-it (1552-1637).
7	Përkthimtaria në shekujt XVII - XVIII; René Descartes (1596-1650) ; Sir John Denham (1615-1669); Abraham Cowley (1618-1667); John Dryden (1631-1700); Alexander Pope (1688-1744); Samuel Johnson (1709-1784); J. W. Goethe (1749-1832); Alexander Tytler (1789 -
8	Provim Gjysmëfinal
9	Përkthimi në epokën e mbretëreshës Viktoria; Thomas Carlyle (1795-1881); Matthew Arnold (1822-1888); Henri Longfellow (1807-1881); Drejtimet themelore tipologjike të përkthimit në epokën e kapitalizmit industrial; Arkaizimi në përkthim; Friedrich Schleiermacher; Newman-i, Carlyle-i, Morris-i; Përkthimtaria angleze në gjysmën e parë të shekullit XX; Përkthimi në botën bashkëkohore.
10	Karakteristika e përbashkët e teorive bashkëkohore të përkthimit; Problemet psikolinguistike dhe konjitive të përkthimit; Strategjia, e bazuar në hulumtimin e procesit të përkthimit. Process-based studies. Metodot: Problemet linguistike të përkthimit; Sferat kryesore të bashkëveprimit të linguistikës dhe përkthimologjisë: Charles Fritz dhe Leonard Bloomfield;
11	Ekuivalenca përkthimore; Tipat e ekuivalentimit; Ekuivalenca situative; Aspektet pragmatike të përkthimit; John Austin - "Teoria e akteve ligjërimore"; Metodot e përshkrimit të procesit të përkthimit - Modeli situativ (ose denotativ); modeli Transformativ; Modeli semantik; Përshtatjet përkthimore;
12	Çështjet e teorisë së përkthimit në traditën e përkthimologjisë angleze; Theodor Savory; Përkthimi i përkryer; Përkthimi adekuat; Përkthimi i veprave klasike; Përkthimi i materialeve tekniko-shkencore; Përkthimi si ngjarje ndërkulturore; Përkthimi, teksti dhe gjuha; Përkthimi artistik; Perspektivat e përkthimologjisë; Përkthimologjia linguistike në SHBA; Casagrande, Quaine, Roman Jakobson; E. A. Nida; Ekuivalentimi formal, Ekuivalentimi dinamik;
13	Përkthimologjia amerikane e viteve '80: Bassnet-McGuire "Hulumtime përkthimore"; S. Ross: "Përkthimi dhe shembëlltyra
14	Bazat e teorive speciale të përkthimit: 1. Veçantitë e përkthimit me gojë; 2. Tipologji e Interpretimit; 2.1. Tipologji e gjuhëve sipas kriterëve profesionale; Kombinimi gjuhësor; Interpretimi i terrenit (interprète de liaison / community interpreter/interprete di comunità); Interpretimi i vijuar (consécutive/consecutiv/consecutivo); 2.4. Interpretimi i njëkohshëm (simultanée/simultaneous/simultanea); 2.5. Interpretimi i njëkohshëm me ndërlidhje (relais/relay); 2.6. Interpretimi me pëshpëritje (chuchotage/whispering); 2.7. Interpretimi me kthim (retour) në gjuhën B; 2.8. Interpretimi me letër (traduction à vue/ sight translation, interpretation/ traduzione a vista); 2.9. Interpretimi në gjuhën e shenjave.
15	Përkthimi në Shqipwri; Zanafilla e përkthimit: një vështrim historik; Diskursi pwrkthimor nw fillim tw shek. XX; 1. Shkretëtira përkthimore e trashëguar; 2. Mungesa e fjalës
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Eco, Umberto, To say almost the same thing, Tirana, 2006 • Even Zohar, Itamar - TOURY, Gideon (eds), Translation Theory and Intercultural realations. Poetics Today, 1981 • Kristoforidhi Konstandin: "Shënime mbi Shqipërinë: Gjuha dhe përkthimi i shkrimeve të shenjta" në: Konstandin Kristoforidhi "Vepra 1", Silver, Elbasan 2001 • At Gjergj Fishta: - "Parathanie" në librin "Poetët e Mëdhej t'Italisë, V. I, Shtypshkronja "Nikaj", Tiranë 1932 • Ashta Kolë "Korbi", Shkëndija, Nr 4, Tetor 1940 • Gjikas: - "Rreth librit "Poetët e mëdhaj t'Italisë" (përgjigje z. M. Kuteli), Shqipëria e re, 4 nëntor 1932 • Gurakuqi Karl: - "Njëmijë e një net", "Bakbuk" (mbi përkthimin e Dh. Falos), Gazeta e re, e shtunë 11 tetor 1929 • Merxhani Branko - "Leon Tolstoj, "Sonata e Kreutzer-it" nga Tajar Zavalani", Nirvana, 25 shtator 1933 • Dom Ndre Mjeda: - "Poetët e mëdhej t'Italisë", v. I, shënime bibliografike, Leka, Nr 9, 1932 • Dom ndre Mjeda: - "Vorret" e Ugo Foscilo-s", nr 1, 1935 • Koma: - "Martesa ndër andrra të një "Xheni" në kllapi" mbi përkthimin e Tajar Zavalanit të "Sonata e Kreutzer-it" të L. Tolstoj, Leka, nr 7, 1937 • Kuteli Mitrush: - "F.S. Noli, Mall e brengë" - vështrim Kritik, Revista "Kritika" 1/ 1944 • Koliqi Ernest: - "Nji vizatues me lapse ari", Nirvana 15 shtator 1933 • Pipa Arshi: - "Kritika", (Përmbledhje artikujsh), Princi, Tiranë 2006 • Valentini Zef (Zalvi): - "Bibliografi, Piroja (nga Jetat Paralele të Plutarkut) përkthyer prej S. Papahristos - Tiranë, Luarasi, 1934 • Valentini Zef: - "Anton Çehov, novela të zgjedhura", i përktheu nga rusishtja Tajar Zavalani". Leka, Nr 3, 1934 • Valentini Zef: - "Bibliografi: "Aventurat e çuditshme të Sherlock Holmesit", "Trimëritë e çuditshme të Allen Pinkertonit"; - përkthyer nga V. XH; "Shkurtabiqi i vërdhë, "Miu i vockël", "Sorkadhe e bardhë" të Komtesa D'Aulnoy, përkthyer nga anglishtja prej Lumo Skëndos; "Sgjedhje përrallash morale të vogla për të rinjtë, përkthyer prej Pikës". Leka, Nr 6, 1934 • Çika Nebil: - "Nëna" e Maksim Gorkit", përkthyer nga Tajar Zavalani, Minerva, 27 janar 1934 • Zavalani Tajar: - "Intervistë mbi përkthimin e tij të Tolstoj", Nirvana, 15 maj 1933 • Valentini Zef (Zalvi): - "Përkëthimi letrar", Leka, Nr 9, 1934 • Valentini Zef (Zalvi): - "Përshtypje prej tri "Kryeveprash", Leka, nr 4, 1935 • Valentini Zef (Zalvi): "Prep përmbi përkëthim të Burrit të Plutarkut, prej Z. S(otir) Papahristos, Leka Nr 8, 1934 • Papahristo Sotir: - "Përkthimi i librit "Piroja" dhe kritika e Z. Zalvi", Leka, Nr 1 1935 • Haxhiademi Etehem: - "Heksametri", Demokracia, 3 mars 1935 • Haxhiademi Etehem: - "Heksametri", Demokracia, 3 mars 1935 • Dragoti Asllan: - "Hamleti" i Fan Nolit, Dielli, Boston 11 nëntor 1927 • Skëndo Lumo: - "Duke kënduar një libër", Nirvana, nr 4 1934 • Peshkëpia Nexhat: "Fan Noli si poet dhe si poet-përkthyes" në librin "Një zemër në mërgim", Përpjekja, Tiranë 2000 • Xhuvani Aleksandër: "Puna e përkthimeve në gjuhën shqipe" (1942) në Aleksandër Xhuvani, Vepra I, faqe 34-41, Akademia e Shkencave të RPSSH, Tiranë 1980 • Xhuvani Aleksandër: "Prapë mbi përkthimin" (1944) në Aleksandër Xhuvani, Vepra I, faqe 41-48, Akademia e Shkencave të RPSSH, Tiranë 1980 • Pika (Kristaq Cipo): - "Shënime kritike përmbi gjuhën: Përkthimet dhe çvillimi i gjuhës letrare", Pepo Marko, Korçë 1930 (455 faqe) • Vangjel Koça: - "Mendime mbi përkthimin në shqip të Dhiatës së Re", në librin "Në udhën e shqiptarizms", Phoenix & Shtëpia e Librit dhe Komunikimit", Tiranë 1999 • Noli Fan S.: - "Introduktat" në Vepra 5, Akademia e Shkencave të RPSSH, 1988 • Kokona Vedat: - "Mbi përkthimin, me përkthyesin", Botimet Kokona, Tiranë 2003 • Tupja Edmond: - "Këshilla një përkthyesi të ri", Onufri, Tiranë 2000 • Tupja Edmond: - "Pro traduttore", Ombra GVG, Tiranë 2004 • Marashi Ardian: - "Përkthimi para gjyqit", At Gjergj Fishta, Shkodër 1996 • Beniamin Walter: "Illuminacione" (Detyra e përkthyesit), Korbi, Tiranë 1998 • Eco Umberto: - "Të thuash gati të njëjtën gjë", Dituria, Tiranë 2006 • Eco Umberto: - "Disa mendime rreth përkthimit", Revista Mehr Licht, Nr 18, Tiranë 2001, fq 179-187 • Steiner Georghe: - "After Babel" (Aspects of language & translation), Oxford Neë York, 1998 • Steiner Georghe: - "Pas Babelit" (Fragment), Revista Mehr Licht, Nr 18 2001 • Heaney Seamus: - "Mbi elegjitë, eklokat, përkthimet, transfuzionet" (intervistë), Revista Mehr Licht, Nr 23, Tiranë 2004 • Ismajli Rexhep: - "Mjeshtëria dhe saktësia e përkthimit" në librin "Gjuhë dhe etni, Rilindja, Prishtinë 1991 • Faini Paola: - "Tradurre" (Dalla teoria alla pratica), Carocci editore, Romë 2004
Referenca të tjera	• Eugene A. Nida, The Theory and Practice of Translation, 1969 • S. Kane, Thomas, How to write English, Oxford Handbook of writing and rhetoric adapted for Albanian, Tirana, CDE, 2010. Adapted for Albanian: Mrs. Majlinda Nishku, I- XV head and Xhevad Lloshi, head XVI - XXIII • Putnam, Hilary, The Meaning of Meaning. Mind, Language and Reality, London: Cambridge UP, 215-271 (tr.it. Mint, linguaggio's realistic. Milan: Adelphi, 1987, 239-297) 7.TOURY, Gideon, In Search for a Theory of Translation, Tel Aviv: The Porter Institute for Poetics and semiotics, Berlin - New York - Amsterdam: Mouton de Gruyter, 1986. Tome 2: 1111-1124 • Da Inglese Contemporanea della theory, Milan: Bonpiani, 1995 • Nest, Gianfranco, Volgarizzare the tradurre, Turin: Einaudi, 1991.4. Nergaard, Syria (ed), La Da Inglese nella storia della theory, Milan: Bonpiani, 1993;
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të aftësohet studenti në thellimin e njohurive shkencore dhe profesionale, si një lëmë i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm, për krijim, pavarësim dhe aftësim në kryerjen e punëve në lëmin e studimit dhe më gjerë.
2	Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë shkencor (ese, detyra kursi, punime të tjera, punime diplome etj.)
3	Të nxitet të analizuarit kritik dhe të menduarit kritik duke u shfaqur në aktin e ndjeshmërisë së veprës si dhe të kuptuarit të saj.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	40
Kuize		0	0
Projekte		0	0
Projekte semestrale		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	10
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	12	0
Gjysmë finale	1	30	30
Provimi final	1	25	25
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			145
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.80
ECTS			6.00